

KONTRATA SOCIALE VLORE

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE

GUSHT 2019 - GUSHT 2020

PËRGATITUR NGA:
QENDRA RINORE E VLORES



Suedi
Sverige



RAPORTI MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE

TË KONTRATËS SOCIALE

BASHKIA VLORË

PROGRAMI: POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

Gusht 2019 – Gusht 2020



Gender Alliance for Development
Qendra Aleanca Gjinore për Zhv.



LEGJENDA Error! Bookmark not defined.

SHKURTIME	6
HYRJE	7
METODOLOGJIA	9
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	10

Gjetje nga informacioni i mbledhur në lidhje me 12 prioritetet e Kontratës Sociale: **11**

KËSHILLI BASHKIAK DHE VEPRIMTARIA E TIJ	12
VLERËSIMI I QYTETARËVE	13
KONTRATA SOCIALE BASHKIA VLORE	14
ANALIZA E GJETJEVE PËR SECILIN PRIORITET SIPAS KONTRATËS SOCIALE	16

Gjetjet nga monitorimi dhe informacioni i bashkisë Vlorë	16
PRIORITET NR. 1	16
PRIORITET NR. 2	19
PRIORITET NR. 3	22
PRIORITET NR. 4	23
PRIORITET NR. 5	24
PRIORITET NR. 6	24
PRIORITET NR. 7	25
PRIORITET NR. 8	27
PRIORITET NR. 9	27
PRIORITET NR. 10	28
PRIORITET NR. 11	29
PRIORITET NR. 12	29

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	30
REFERENCA	32
ANEKS	34



Gender Alliance for Development
Qendra Aleanca Gjinore për Zhv.



Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile
Civil Society Development Center



Falenderime

Për të hartuar këtë raport gjatë periudhës gusht 2019 - gusht 2020, dëshirojmë të falenderojmë në radhë të parë qytetarët dhe të rinjtë që ishin pjesë proaktive e këtij monitorimi, mediat lokale dhe sociale që veprojnë në qytet, Bashkinë Vlorë me drejtoritë e institucionet e varësisë dhe disa anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Një falenderim shkon dhe për anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) të cilët kanë kontribuar për monitorimin dhe përgatitjen e raporteve të ngjashme të monitorimit në bashki të tjera ku rrjet punon.

Gjithashtu dëshirojmë të falenderojmë **Olof Palme International Center** dhe **NED – National Endowment for Democracy** për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohej ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.



Gender Alliance for Development
Qendra Aleanca Gjinore për Zhv.



Rrjeti POP

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP 2019, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy.

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

Qendra “Aleanca Gjinore per Zhvillim, Tiranë;
Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
Qendra Rinore Vlorës,
Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamez;
Epoka e Re, Fier;
Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
Qendra Rinore për Progres, Kukës,
Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec.

Ky raport është përgatitur nga Qendra Rinore e Vlorës në kuadër të projektit POP 2020 “Monitorimi i zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal” dhe nuk përfaqëson qëndrimin e Olof Palme International Center dhe National Endowment for Democracy. Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi vetëm e autorëve.



Gender Alliance for Development
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim





Shkurtime

POP	Përballja e Ofertave Politike
NJQV	Njësi të Qeverisjes Vendore
Nj.A	Njësia Adminsitrativ
RAT	Reforma Administrative-Territoriale
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
U.K Vlorë	Ujësjiellës Kanalizime Vlorë Sh.a.
OPIC	Qendra Ndërkombëtare Olof Palme
NED	National Endowment for Democracy
VYC	Qendra Rinore e Vlorës
QAGJZH	Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”
VKB	Vendime të Këshillit Bashkiak



Gender Alliance for Development
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Hyrje

Gjatë vitit 2019 organizatat e Rrjetit POP zbatuan projektin "Përballja e Ofertave Politike - 2019 (POP 2019)" në 9 bashki të vendit, Tiranë, Durrës, Kukës, Pukë, Vlorë, Fier, Kamëz, Pogradec, Shkodër. Përgjatë vitit 2019 u arrit që të nënshkruheshin Kontrata Sociale të hartuara bazuar në prioritetet e komunitetit midis kryetarëve të rinj të bashkive dhe përfaqësuesve të organizatave anëtare të POP që veprojnë në bashkitë e sipër përmendura.

Gjatë vitit 2019, para dhe gjatë fushtës elektorale ne jemi fokusuar tek sjellja së bashku e grupeve lokale të qytetarëve në zonat urbane dhe rurale për të zgjedhur përparësitë e tyre dhe më pas prezantimit të përparësive të përzgjedhura dhe të përmbledhura në Kontrata Sociale për kandidatët në zgjedhjet vendore. Hartimi i Kontratës Sociale bëri që komuniteti të ketë një mjet për të mbajtur kandidatët e zgjedhur për Kryetar Bashkie dhe Këshillin e Bashkisë përgjegjës për adresim e tyre.

Forumet publike me komunitetin kanë adresuar çështjet e (i) shërbimeve publike; (ii) zhvillimi ekonomik vendor (iii) dimensionit social dhe (IV) demokracia vendore. Kontakti i drejtpërdrejtë me qytetarët nga zonat rurale dhe urbane të përfshira në proces kontribuoi me propozime konkrete si prioritetet e komuniteteve të tyre.

Përmes vjeljes së opinionëve të qytetarëve në identifikimin dhe përcaktimin e prioritetëve lokale, rrjeti POP synon të krijojë dhe promovojë mekanizma qytetare në funksion të përmirësimit të demokracisë lokale. Kontrata Sociale mundëson vlerësimin dhe monitorimin e performancës së administratës lokale dhe të zgjedhurve vendorë duke promovuar dialog dhe bashkëpunim në nivel vendor.

Forumi për nënshkrimin e Kontratës Sociale u organizua në datë 11 tetor 2019, përmes firmosjes nga nën/kryetari i bashkisë Vlorë dhe në prezencë të kryetares së Këshillit Bashkiak, u ra dakord, që prioritetet kryesore të pasqyruara në këtë kontratë, do të ishin përparësi e punës së Bashkisë Vlorë për mandatin 2019 – 2023.

Gjatë vitit 2020 projekti vijoi me "Monitorimin e zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal." Gjatë kësaj faze të kësaj nisme POP synon që të llojë dhe të advokojë për përmbushjen e prioritetëve të qytetarëve që janë nënshkruar në Kontratat Sociale për bashkitë: Tiranë, Kamëz, Durrës, Fier, Vlorë, Shkodër, Kukës, Pukë dhe Pogradec, gjithashtu synon përfshirjen e

komunitetit në vendimmarrje. Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioriteteve të kontratës sociale për periudhën gusht 2019 – gusht 2020.

Kjo periudhë përfshin procesin e konsolidimit të QV, njohjen me prioritetet e Kontratës Sociale, deklarimin publik të Kontratës Sociale në një takim të hapur me aktorët kryesorë vendor si dhe monitorim të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak dhe të zbatimit të prioriteteve të Kontratës Sociale.

Prioritetet e Kontratës Sociale ofrojnë një mundësi shumë të mirë që bashkia të kuptojë nevojat dhe përparësitë e qytetarëve. Harmonizimi dhe përfshirja e rezultateve të monitorimit në programet vendore, përmes proceseve të advokimit si dhe përpjekja për të influencuar në hartimin e politikave vendore, janë një tregues pozitiv i transparencës dhe llogaridhënies.

Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, Qendra Rinore e Vlorës për një periudhë të rëndësishme të vitit 2020 (mars-qershor 2020) ka përshtatur aktivitetet për të ndjekur reagimin e qeverisjes lokale, Bashkisë Vlorë dhe Këshillit Bashkiak, në monitorimin e zbatimit të masave ndaj fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë, si dhe problemet e komunitetit në përshtatje me protokollet e siguriës.

Gjatë periudhës gusht 2019 - gusht 2020 organizata kishte qëllim:

- Të prezantojë prioritetet e Kontratës Sociale dhe procesin e hartimit të tyre;
- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë Covid-19;
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet;
- Të llobojë dhe advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve sidomos në kuadër të Dimensionit Social, Transparencës dhe Llogaridhënies.

Metodologjia

Për të realizuar raportin Qendra Rinore e Vlorës, pjesë e rrjetit të POP u bazua në hapat si më poshtë:

- U monitorua puna e Bashkisë Vlorë dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për periudhën gusht 2019 – gusht 2020;
- U përgatit dhe dërgua një kërkesë për informim me email, Bashkisë Vlorë sipas prioriteteve të Kontratës Sociale;
- U përgatit dhe dërgua një kërkesë për informim në lidhje me vendimmarjen e Këshillit Bashkiak për prioritetet e qytetarëve të dala nga Kontrata Sociale 2019;
- Monitorim i mbledhjeve offline dhe online të Këshillit Bashkiak;
- U organizuan disa takime me staf të Bashkisë Vlorë mbi progresin e prioriteteve të komunitetit;
- U realizuan 5 takime me anëtarë të komunitetit në njësitë administrative të Vlorës, që vlerësuan progresin e prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Monitorimi i implementimit të buxhetit dhe prioriteteve të Kontratës Sociale përmes të dhënave të hapura dhe prokurimeve publike;
- Konsultimi i dokumentave dhe strategjive të Bashkisë Vlorë, buxheti afatëmesëm dhe ai vjetor, faqja e internetit e Bashkisë, etj;
- Analizim i monitorimit të mediave audio vizive dhe on line sipas fushave specifike.

Përmbledhje Ekzekutive

Monitorimi njëvjeçar i Kontratës Sociale, vendos bazën mbi të cilat, Bashkia e Vlorës, Këshilli Bashkiak do të monitorohen dhe grupet e qytetarëve do të artikulojnë progresin e prioriteteve të tyre, prej 2019 në vitet në vazhdim.

Të 12 prioritetet janë adresuar pjesërisht përmes hartimit të projekteve, planifikimit në buxhetin vendor, projekteve qeveritare dhe ndërmarrjes së nismave e politikave për përmirësimin e tyre, në total të 12 prioriteteve vlerësojmë se 46.91% e tyre janë realizuar. Vëmë re se të gjitha prioritetet janë adresuar me investime, projekte të hartuara në kërkim të fondeve, por edhe të vendosura në agendën e punës nga Bashkia Vlorë.

Ne jemi të vetëdijshëm që realizimi i prioriteteve të Kontratës Sociale kërkon investime si në burime njerëzore dhe më shumë në burime financiare dhe Bashkia Vlorë me buxhetin vjetor ose afatëmësëm, që administron përballat me shumë sfida, për të adresuar zgjidhje, por është e rëndësishme të theksojmë se artikulli, adresimi i nevojave dhe diskutimi e monitorimi i tyre nga qytetarët dhe stafi i NJ.Q.V është në funksion të ngritjes së urave të komunikimit për të përmirësuar ndërveprimin midis palëve dhe duke forcuar në këtë mënyrë edhe demokracinë lokale.

Viti 2020 ishte një vit i vështirë nga pandemia e Covid-19, që limitoi shërbime cilësore ndaj qytetarëve dhe afektoi gjithë ekonominë dhe sitemin shëndetësor. Bashkia e Vlorës u përball me burime të limituara financiare, gjithsesi besojmë se Bashkia e Vlorës do të gjejë mundësi që të përfundojë projektet e nisura, sidomos ato që kanë të bëjnë me prioritetet e infrastrukturës publike, shërbimet e transportit, shërbimet ndaj fermerëve, grave dhe të rinjve, etj.

Çdo prioritet i Kontratës Sociale përmban një listë të gjatë indikatorësh, vëmë re se ka përpjekje pozitive nga Bashkia Vlorë, që është duke i dhënë prioritet edhe ndërhyrjeve me investime drejt Njësive Administrative, që me transferimin e shërbimeve nga RAT, gjenden në situatë kritike për tu ofruar qytetarëve mundësi dhe akses të drejtë në shërbime.

Këshilli Bashkiak që nga dita e konstituimit të tij e në vazhdim, ka miratuar 5 rregullore, që në thelb përmirësojnë komunikimin dhe ndërveprimin me aktorë të rëndësishëm të territorit, ndërsa do të duhet ende kohë dhe përpjekje që këto dokumente të rëndësishme të njihen dhe të vihen në jetë nga ky institucion vendimarrës.

Gjatë monitorimit është vënë re, që Bashkia Vlorë dhe Këshilli Bashkiak vazhdojnë të shfaqin probleme në lidhje me komunikimin dhe përfshirjen e qytetarëve në procese të përbashkëta dhe në mjaft raste, Bashkia Vlorë dhe KB Vlorë duhet të luajë rolin që qytetarët i kanë mandatuar duke qënë më pranë komunitetit dhe duke mbështetur shqetësimet e tyre në vendimarrje gjithëpërfshirëse dhe jo të njëanshme.

Pjesëmarrja qytetare në monitorimin e Kontratës Sociale vlerësohet pozitive, ata janë pyetur dhe kanë dhënë komente për përmbushjen ose jo të çdo prioriteti. Vlerësojmë presionin pozitiv të qytetarëve dhe medias lokale që vazhdojnë të kërkojnë që prioritetet e tyre të zgjidhen duke dhënë rekomandime përkatëse.

Gjetje nga informacioni i mbledhur në lidhje me 12 prioritetet e Kontratës Sociale:

Prioriteti 1: - Investimet e ralizuar që përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore dhe blloqet e banimit, janë duke dhënë rezultate pozitive për komunitetin. Theksojmë se rreth 50% e prioritetëve janë realizuar dhe është ende duke u punuar për finalizimin e tyre. Ndërsa ndërhyrja në Nj.A të Novoselës është përshëndetur nga gjithë komuniteti.

Prioriteti 2: - Situata vlerësohet pa shumë rrezultate për banorët ndërsa bashkia është duke hartuar projekte në Nj.A dhe kërkon donatorë për mbështetje financiare. Është duke përfunduar ujësjellësi në zonën e Dukatit, ndërsa po punohet për Nj.A Novoselë për përcaktimin e projekteve prioritare. Në qytetin e Vlorës dy projekte madhore janë prokuruar për zonën e lungomares dhe atë të Transballkanikes.

Prioriteti 3: - Përmirësimi i cilësisë së kanalizimeve, vazhdon të mbetet një sfidë për Nj.A ku pothuajse nuk ekziston rrjeti i kanalizimeve, ndërsa në Vlorë falë mbështetjes së qeverisjes qendrore, po finalizohet sistemimi dhe trajtimi i ujërave të zeza në disa prej lagjeve periferike. Gjithashtu edhe në shëtitoren kryesore po përfundon një tjetër projekt.

Prioriteti 4:- Në lidhje me transportin publik, nevojitet përmirësim dhe shtim i linjave të reja jo vetëm në qytet në zonat periferike, por edhe në Nj.A. Ndërsa periudha e pandemisë vuri në vështirësi serioze shërbimin e transportit, pritet në vitin e ardhshëm të kemi përmirësim.

Prioriteti 5:- Në Bashkinë e Vlorës ka filluar puna për ndërtimin e venddepozitimit të mbetjeve urbane, në zonën e Sherishtës dhe pritet që së shpejti të bëhet funksional për të ofruar shërbimin e grumbullimit dhe përpunimit të mbeturinave për Bashkitë e Vlorës dhe Selenicës.

Ndërkohë për **prioritetin 7**, atë të përmirësimit të pastrimit të qytetit dhe Nj.A, evidentohet fakti se në muajin gusht, Nj.A të Shushicës dhe Qendrës, do të përfitojnë nga shërbimi i pastrimit të mbeturinave, shërbim që nuk kryhej më parë, ndërsa pjesërisht ofronte shërbim të kufizuar Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, tani ky shërbim është tenderuar dhe qytetarët mbeten në pritje të një shërbimi cilësor.

Prioriteti 8:- Zhvillim i programeve për mbështetjen e fermerëve dhe përfundimi i procesit të menaxhimit të tokave, është evidentuar se progresi është në nivele të ulta, procesi po ecën ngadalë, ndërsa nevojitet më tepër mbështetje për këtë prioritet të rëndësishëm.

Prioriteti 9: Bashkia e Vlorës duhet të fokusohet më tepër në informimin e qytetarëve për pagesën e taksave, ndërsa bashkëvepron me sektorin e biznesit nevojitet ky bashkëpunim edhe qytetarët.

Prioriteti 10:- Bashkia dhe Këshilli Bashkiak duhet të ndërmarrin nisma që fuqizojnë aksesin në punësim kryesisht në sektorin e turizmit për kategoritë e grave dhe të rinjve. Janë hedhur disa hapa të parë, por kërkohet që të punohet më shumë, dukë parë edhe profilin e Vlorës, si një qendër e rëndësishme e turizmit.

Prioriteti 11:- Buxhetimi me Pjesëmarrje është një praktikë pozitive e realizuar prej disa viteve në Bashkinë Vlorë, ndërkohë që duhen përmirësuar mekanizmat e pjesëmarrjes dhe duhen riparë forma alternative të marrjes së mendimeve dhe forma alternative të bashkëveprimit me qytetarët.

Prioriteti 12:- Bashkia e Vlorës ka ngritur Këshillin Vendor të Rinisë, por nevojiten përpjekje që të bashkëpunojë dhe ndërveprojë me këtë strukturë të formalizuar.

Këshilli bashkiak dhe veprimtaria e tij

Këshilli Bashkiak i Vlorës është konstituar më datë 7 gusht 2020. Ai përbëhet nga 51 anëtarë, nga të cilët 24 gra (47%) dhe 27 burra (53%). Përgjatë periudhës gusht 2019-gusht 2020, janë realizuar 21 mbledhje të KB Vlorë dhe janë miratuar rreth 123 vendime, nga të cilat 24 janë vendime që kanë lidhje drejtëpërdrejtë me prioritetet e Kontratës Sociale. Përgjatë periudhës janar – maj 2020, KB i Vlorës ka miratuar 5 rregullore, përmes të cilave rregullon marrëdhëniet me bashkinë, qytetarët, median dhe organizata të shoqërisë civile.



Gender Alliance for Development
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile
Civil Society Development Center



qendra rinore e vlorës
V.Y.C.
vlora youth center



Association for Inclusive and Social Action



"Young Intellectuals, Hope"
IRSH
"Intelektualët e rinj, Shpresa"



lëvizja rinore
për demokraci



Center for
Youth Progress



rias



ER

Në bazë të rregullores që hyri në fuqi në janar 2020, Këshilli Bashkiak, përbëhet nga 12 Komisione të Përhershme që janë si më poshtë:

1. Komisioni juridik i rendit dhe i sigurisë vendore publike.
2. Komisioni i për çështjet e ekonomisë, financave dhe privatizimet
3. Komisioni i mandateve dhe i rregullores
4. Komisioni i shërbimeve publike, transportit, infrastrukturës dhe strehimit
5. Komisioni për arsimin, kulturën dhe sportet.
6. Komisioni për zhvillimin urbanistik dhe ndërtimet.
7. Komisioni i Shëndetësisë, Veterinarisë, Mjedisit dhe zhvillimin e turizmit.
8. Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve dhe Menaxhimit të ujrave.
9. Komisioni i mbikqyrjes, kontrollit dhe nënshkrimin e procesverbaleve të mbledhjeve.
10. Komisioni për Marrëdhënjet me jashtë dhe Integrimin Europian
11. Komisioni i barazisë gjinore dhe përfshirjen sociale
12. Komisioni i peticioneve.

Gjatë periudhës, Qendra Rinore e Vlorës ka monitoruar mbledhjet e KB Vlorë në lidhje me vendimet të cilat prekin prioritetet e Kontratës Sociale. Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID 19, gjatë marsit të 2020 e në vazhdim, mbledhjet e Këshillit zhvillohen online dhe transmetohen në median sociale të KB Vlorë.

Vlerësimi i qytetarëve

Për monitorimin dhe marrjen e një reagimit nga komuniteti mbi progresin e prioriteteve të Kontratës Sociale janë realizuar pesë takime me komunitetin me pjesëmarrje të 77 personave nga të cilët 59 vajza/gra dhe 18 djem/burra.

Gjatë takimeve me qytetarët që u zhvilluan në periudhën korrik–shtator 2020, u bënë prezantuan prioritetet e Kontratës Sociale dhe u kërkuar vlerësimi komunitar për përmirësimin e situatës së identifikuar. Qytetarët ishin të vetëdijshëm që shumë prej prioriteteve kërkojnë investime të Bashkisë Vlorë, ndërsa perioda e pandemisë Covid-19, duket që i ka frenuar këto investime. Gjithsesi pjesëmarrësit diskutuan në frymën e investimit komunitar dhe të përmirësimit të cilësisë së jetës së tyre, përmes vlerësimeve që dhanë për çdo prioritet. Vlerësimi i tyre është pasqyruar në vlerësimin e detajuar të çdo prioriteti dhe në rekomandimet përkatëse.

Banorët perceptojnë ndryshime në lidhje me rrugët kryesore të qytetit dhe rrugët kryesore që lidhin Vlorën me dy Nj.A e tjera, por ende janë problematike rrugët në lagjet e brendshme dhe ato ndërlidhëse midis fshatrave. Sipas qytetarëve rreth 80% e rrugëve në NJA janë të lëna pas dore, pa investime dhe mungojnë trotuarët. Banorët kërkojnë që trotuaret e reja të planifikohen me gjerësi të mjaftueshme dhe me ndriçim.

Trasporti publik ka qënë një shërbim që nuk ofrohet në lagjet periferike dhe në Nj.A, banorët shpreheshin se këtë shërbim e bëjnë privatisht dhe nuk e përfitojnë nga Bashkia.

Shërbimi i pastrimit në Vlorë vlerësohej nga qytetarët, gjithsesi ata shtojnë se ka nevojë për nevojë për shtim të koshave dhe tërheqje të mbeturinave edhe në lagjet e brendshme të qytetit, ndërsa Nj.A të Shushicës, Qendrës raportojnë se ky shërbim mungon tërësisht, vetëm në disa raste punonjësit e bashkisë kanë bërë tërheqjen e mbeturinave.

Banorët shprehen të pakënaqur si me sasinë ashtu edhe me cilësinë e ujit. Në qytet ka ujë vetëm dy herë në ditë në zona të veçanta, ndërsa raportohet se uji i pijshëm blihet.

Kanalizimet janë të amortizuara në disa pjesë periferike të qytetit dhe bëhen shkak për ndotje të ambientit. Ndërsa në disa Nj.A nuk ekzistojnë ose janë tërësisht jashtë funksionit.

Në lidhje me transparencën në vendimarrje, Bashkia ka kanale zyrtare të komunikimit me qytetarët, por ata kanë mungesë informacioni për çështje që ata i konsiderojnë të rëndësishme që të informohen në kohë reale.

Ndërsa çështja e pronësisë së tokave bujqësore vazhdon të jetë një shqetësim për banorët e Nj.A. Ndërsa kërkohet me tepër mbështetje në sektorin e bujqësisë me informacione dhe asistencë të drejtëpërdrejtë.

Kontrata Sociale Bashkia Vlorë

Autoritetet lokale janë përgjegjëse për të garantuar që qytetarët marrin shërbime dhe mbështeten për mirëqenien e tyre. Por janë qytetarët, të rinjtë dhe aktorët e shoqërisë civile, që përmes mekanizmave të ndryshëm qytetarë duhet t'i mbajnë ata përgjegjës në formulimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe shërbimeve lokale.

Ndërsa Shqipëria ishte në prag të zgjedhjeve lokale të vitit 2019, qytetarët dhe të rinjtë, vazhdojnë të mbeten të nënpërfaqësuar dhe mbetet ende punë për të bërë, në mënyrë që të adresohen nevojat dhe shqetësimet e tyre.

Për këtë qëllim u realizuan 6 forume, me pjesëmarrje të 122 personave, anëtarë të komunitetit dhe të rinj (95 gra/27 burra), banorë të rajoneve të qytetit të Vlorës, Novoselës, Orikumit, Qendër Vlorës dhe Shushicës, në mars 2019 me qëllim diskutimin e çështjeve me interes për komunitetet lokale, si dhe identifikimin e prioritetëve të zhvillimit vendor në këndvështrimin qytetar. Në secilin prej forumëve u përfshinë qytetarë të grup-moshave dhe gjinive të ndryshme, të punësuar dhe të papunë, me nivele të ndryshme arsimore, si dhe individë që u përkasin kategorive në nevojë të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Në forume pjesëmarrësit diskutuan gjerësisht 26 çështje që përfshihen në katër fusha kryesore që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi komunitetin vendor: (i) Shërbimet publike; (ii) Zhvillimi ekonomik vendor; (iii) Dimensioni social dhe (iv) Demokracia vendore. Për secilën prej 26 çështjeve objekt diskutimi ata dhanë këndvështrimin e tyre mbi gjendjen aktuale, si dhe diskutuan mbi prioritetet që në këndvështrimin e tyre duhet të përfshihen në axhendën e të zgjedhurve vendor.

Mbi bazën e vlerësimit të vetë pjesëmarrësve prioritetet e komunitetit u organizuan në dy grupe: 1. Ndërhyrje prioritare, ku përfshihen çështjet që në këndvështrimin e komunitetit janë shumë të rëndësishme për ta dhe kërkojnë më shumë angazhim në vijim nga të zgjedhurit vendorë; 2. Ndërhyrje disi prioritare, që përfshijnë ato çështje që janë më pak të rëndësishme krahasuar me grupin e parë.

Janë 32 prioritetet e komunitetit të prezantuara gjerësisht, sipas shkallës së rëndësisë që i ka dhënë vetë komuniteti, për të cilat do të lobohet për të qenë pjesë e axhendës së të zgjedhurve të rinj vendor, sikurse përmbushja e të cilave do të monitorohet në vijim nga vetë komuniteti. Nga të gjitha këto prioritetet, banorët pjesëmarrës në forume veçuan si më prioritare 12 prej tyre të cilat u përfshinë në Kontratën Sociale – Vlorë.

Nxjerrja e prioritetëve konkrete për çdo njësi administrative të Vlorës, ishte një hap i rëndësishëm për procesin. Në bazë të këtyre prioritetëve, në tetor të vitit të kaluar më datë 11.10.2019, mes Bashkisë Vlorë dhe Qendrës Rinore të Vlorës u firmos Kontrata Sociale.

Prej momentit të nënshkrimit, Qendra Rinore e Vlorës, pjesë e rrjetit të organizatave që implementojnë në rang kombëtar projektin POP – Përballja e Ofertave Politike, është duke

monitoruar përmbushjen e prioriteteve dhe të monitorojë pritshmëritë që komuniteti ka ndaj kësaj kontrate sociale.

Analiza e gjetjeve për secilin Prioritet sipas Kontratës Sociale

Ky raportim është bazuar në përgjigjet e kërkesës për informacion që Qendra Rinore e Vlorës i ka dërguar Bashkisë Vlorë, kthimi i përgjigjes nga Bashkia dhe Këshilli i Bashkisë, më datë 22.07.2020, nr. protokollit 6063/1, si dhe kthimin e përgjigjes së Ujësjiellës Kanalizime Vlorë Sh.A më datë 28.07.2020, nr. prot. 1200, takimeve me staf të Bashkisë, në monitorimin në terren të aksioneve dhe punës së bashkisë, monitorimin e mediave (kryesisht medias sociale) si dhe në informacionet e mbledhura nga të dhënat e hapura (shpenzime dhe prokurime) të qeverisjes vendore si dhe nga takimet me qytetarë të njësive administrative të bashkisë Vlorë. Gjithashtu janë analizuar dhe vendimet e miratuara nga Këshilli Bashkiak i Vlorës për periudhën gusht 2019 - gusht 2020.

Progresi i realizimit të prioriteteve raportohet në disa faza që janë:

Prioritet i pa realizuar

Prioritet i adresuar pjesërisht (*Prioritet i buxhetuar ose Prioritet i prokuruar*)

Prioritet i realizuar

Nga analizimi i këtyre të dhënave rezulton se Bashkia Vlorë ka adresuar prioritet si më poshtë:

Gjetjet nga monitorimi dhe informacioni i bashkisë Vlorë

PRIORITET NR. 1: INFRASTRUKTURË, RRUGË DHE TROTUAJE

- Investime që përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore dhe blloqet e brendshme të banimit.

Për rajonet e qytetit Vlorë. I nevojshëm rikonstruksioni i rrugëve ose i blloqeve të brendshme të banimit: Zona tek Fusha e Drurit, rruga tek Tregu i Madh, rruga pas KSHA-së, lagjia pas kopshtit Nr 10, rruga nga fabrika e tullave, rruga nga Porti drejt plazhit të vjetër, rruga "Jani Kosta", rruga dhe e gjithë lagjia pas Stadiumit, rruga tek fusha e aviacionit. Vendosi e sinjalistikës horizontale dhe/ose vertikale në zonat ku aktualisht mungon.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020.

Përgjatë periudhës parazgjedhore prill-qershor 2020, është realizuar rikonstruksioni i segmenteve rrugore pranë Zonës tek Fusha e Drurit, rruga tek Tregu i Madh, rruga pas KSHA-së, përmes shtrimit të rrugëve, vendosjes së ndriçimit dhe shtrimi i rrjetit të kanalizimit. Gjithashtu ka përfunduar edhe shtrimi i rrugës nga Porti Detar drejt Plazhit të Vjetër duke lidhur investimin me rrugën e Plazhit të Vjetër dhe është përmirësuar përmes shtrimit të 200 m rrugë, një prej pjesëve më të amortizuara në segmentit rrugor, pranë zonës së ish fabrikës së Sodës dhe janë prerë edhe pemët e dëmtuara të rrugës në Pyllin e Sodës, duke rritur aksesin në pjesën turistike të zonës midis Plazhit të Vjetër dhe Zvërnecit.

Gjithashtu është shtruar rruga pas stadiumit Flamurtari, ndërsa rrugët e lagjes pas stadiumit ose zonës të zjarrfikësja sic njihet në qytet, vazhdojnë të jenë problem shqetësues për banorët. Ndërkohë mbeten ende pa u realizuar rrugicat e lagjes pas Kopështit nr. 10; rruga nga fabrika e Tullave drejt Pusit të Mezin; dhe lagja të Kopshtit nr. 10; rruga Jani Kosta; rrugët e zonës të Fusha e Aviacionit.

Ndërsa Bashkia Vlorë ka buxhetuar zerin e investimeve: Reabilitimi dhe riasfaltimi i disa akseve kryesore në qytetin e Vlorës me vlerë 70 007 000 leke, është lidhur kontrata më datë 20.07.2020 me vlerë 49,500,007 Lekë, me një operator ekonomik, por nuk ka të dhëna cilat janë rrugët ku do të ndërhyet.

Në rrugët që janë kryer investime, kryesisht janë shtruar edhe trotualet, edhe pse raportohen që ata janë të ngushtë dhe është përmirësuar sinjalistika horizontale, ndërsa ajo vertikale (semaforët) nuk ekziston.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është: Nga 10 indikatorë janë përfunduar 5 dhe progresi vlerësohet në masën 50% + i arritur. Prioritet i adresuar pjesërisht.

Novoselë. Ka nevojë për ndërhyrje urgjente në rrugët kryesore në fshatrat: Trevllazër, Cerkovinë, Skroftinë, si dhe rruga e varrezave Cerkovinë.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:

Një segment rrugor mjaft problematik me infrastrukturë të dëmtuar, ka qënë pjesë e gjetjeve të Kontratës Sociale, por edhe protestave dhe kërkesave të qytetarëve të kësaj zone. Ndërsa në periudhën parazgjedhore Bashkia e Vlorës filloi investimin duke përmirësuar një pjesë të rrugës së Trevllazërit, në dhjetor, në buxhetin e vitit 2020 u planifikuan në zërin e investimeve: - Reabilitimi dhe riasfaltimi i rrugës Cerkovinë – Skroftinë – Trevllazër, me vlerë totale 56.000.000 lekë të reja.

Nga komunikimet zyrtare të Bashkisë Vlorë, si edhe nga monitorimi, në Njësinë Administrative Novoselë, në fshatrat Trevllazër, Cerkovinë, Skroftinë janë drejt përfundimit në riasfaltim dhe

rehabilitim. Fondi i përdorur ka qenë 42964663 lekë dhe diferenca është rialokuar pas miratimit në Këshillin Bashkiak edhe për rrugën e varrezave të fshatit Cerkovinë.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 100% dhe është prioritet i realizuar.

Orikum. I nevojshëm rikonstruksioni i rrugës tek Kisha e Marmiroit, rrugës buzë detit, rrëza e kanalit Dukat, rrugët e brendshme në Tragjas. Zgjerim i rrugëve të Radhimës dhe të Thilpetit.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:

Nga lista e indikatorëve për ndërhyrje në Nj.A Orikum, është futur në buxhetin e 2020, te lista e prioritetëve për investime, vetëm sistemim-asfaltim i rruges Orikum-Kisha e Marmiroit me një parashikim prej 105,000 lekë.

Nga monitorimet dhe komunikimet e Bashkisë Vlorë, është marrë në konsideratë kërkesa e komunitetit, aktualisht është arritur deri në fazën e projektimit, por që nuk është marrë ende asnjë vendim konkret për mungesë të fondeve. Ndërsa pastrimi i i kanaleve në Tragjas, Dukat dhe Radhimë është një process që po realizohet. Të gjithë indikatorët e tjerë nuk janë realizuar.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 10% dhe është prioritet i përcaktuar.

Qendër Vlorë. Kërkohet ndërhyrje urgjente në rruget lidhëse të Bestrovës, Kërkovës, Hoshtimës, Sherishtës, Babicë e Vogël dhe Xhyherinës.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:

Nj. A Qendër është një njësi me mjaft problematika në infrastrukturë, ku mungojnë prej vitesh investimet. Gjithsesi në buxhetin e vitit 2020, Bashkia Vlorë liston si prioritate për investime me projekte me vlera investimi ndërhyrjet në rikonstruksionin e rrugës së fshatit Oshëtim me vlerë 90,000.000 lekë dhe rehabilitimi dhe riasfaltimi i rruges se Xhyherines 27,000.000 lekë.

Nga monitorimi i realizuar dhe administrimi i përgjigjeve të Bashkisë, deri në muajin gusht 2020, situata është si më poshtë:

Rehabilitimi dhe riasfaltimi i rrugës Babice - Xhyherine, është në fazë tenderimi. Data e mbajtjes së tenderit është përcaktuar data 08.09.2020 me një vlerë fondi prej 21 664 090,00 Lekë. Po në të njëjtën fazë tenderimi është edhe rehabilitimi dhe riasfaltimi i rrugës lidhëse të Sherishtës.

Ndërsa rrugët lidhëse të Bestrovës, Kërkovës dhe Hoshtimës janë në fazë projektimi.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 40% dhe është prioritet i adresuar pjesërisht (Prioritet i buxhetuar dhe prioritet i prokuruar).

Shushicë. Kërkohet rikonstrukcion i rrugës Shushicë-Beshisht, rrugës së varrezave në fshatin Drithas dhe rrugës kryesore në Shushicë.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:

Edhe Nj. A Shushicë, vuan prej vitesh mungesën e investimeve, ndërsa po bëhen përpjekje maksimale nga ana e komunitetit që nevojat e tyre të përfshihen në listën e investimeve të Bashkisë Vlorë. Gjithsesi edhe Bashkia Vlorë ka planifikuar në buxhetin e vitit 2020, ndërhyrje thelbësore për këtë Nj.A. janë përfunduar projektet dhe janë buxhetuar ndërhyrjet e mëposhtme:

Rikonstrukcion i rrugës së Fshatit Drithas 2,600.000 lekë

Sistemim-asfaltim i rrugës Cezma Llakatundit-Ura Grabian 20,000.000 lekë

Sistemim-asfaltim i rrugës Ura Grabian – Rezervuar Fshat 22,000.000 lekë

Sistemim-asfaltim i rrugës Qender Shushice – Beshisht 33,000.000 lekë

Sistemim-asfaltim i rrugës Lapidar Ceprat – Qendër Ceprat 24,000.000 lekë

Gjithsesi nga komunikimet me Bashkinë dhe monitorimin e realizuar aktualisht:

Rruga e varrezave bashkë me gjithë rrugën e fshatit Drithas është tenderuar dhe është në fazë realizimi. Kontrata është lidhur në datë 17.08.2020 me numër kontrate 55 me vlerën fondi 2 125 593,00 Lekë. Ndërsa rruga kryesore e Shushicës ende nuk është asfaltuar.

Rruga Shushicë – Beshisht është një premtim që do të buxhetohet brenda vitit 2021.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 50%+ dhe është prioritet i adresuar pjesërisht (Prioritet i buxhetuar dhe prioritet i prokuruar)

PRIORITET NR. 2: FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM

- Adresimi me prioritet i furnizimit me ujë për:

Për rajonet e qytetit Vlorë. Furnizimi me ujë në zonat ku aktualisht ka ujë vetëm një herë në 24 orë. Përmirësim i cilësisë së ujit të pijshëm.

Sipas referimeve të Nën/kryetarit të Bashkisë të takimi i POP 2019 është dukë mbaruar studimi i fizibilitetit për furnizimin me 24 orë të Vlorës me ujë të pijshëm, përmes një projekti që financohet nga KfV-ja, ndërsa projekti i ritransmetimit do të zbatohet pas gusht 2020.

Duke ju referuar komunikimit zyrtar nga ana e “Ujësjetllës Kanalizime Vlorë Sh.a.”, por gjithashtu duke iu referuar monitorimit të vazhdueshëm në terren, në qytetin e Vlorës gjithë zona nga stacionet në Ujë të Ftohtë deri në Depot e Qytetit, Bishti i Kalldrëmit dhe Kuzbaba, si edhe nga Stacioni i Ujit të Ftohtë deri në Radhimë dhe zona e Lungomares deri në Skelë ka furnizim me ujë 24 orë, pa ndërprerje.

Problematikë ka në zonat periferike, dikur jo-formale si zona mbi Spital, Zona e Ish Fushës së Aviacionit, Zona e Pyjores, duke qenë se janë zona fundore, kanë marrë zhvillim pas investimit në ujësjellës në vitin 2009.

Në lidhje me sigurinë dhe pastërtinë e ujit qytetin e Vlorës çdo ditë monitorohet cilësia e ujit të pijshëm, si edhe siguria nga Njësia e Shëndetit Publik. Kontrolli bëhet në 22 pika ku ekzaminohen parametrat kryesorë të ujit të pijshëm, përmbajtja e përqindjes së klorit rezidual në ujë dhe ngarkesa bakteriale MPN. Përcaktohet cilësia dhe siguria për konsum të ujit.

Ndërkohë gjatë monitorimit tonë jemi vënë në dijeni që një tender është hapur nga Bashkia Vlorë, me financim të Buxhetit të Shtetit, **"Projekti Zbatimi për Ujesjellesin Zona e Ujit të Ftohtë dhe Lungo Mares Rrapi Uji i Ftohtë – Shkolla e Marinës"** me vlerë 642,013,109 lekë, që përfshin:

Rrjet të ri shpërndarës Zona e Ujit të Ftohtë;
Rrjeti i ri shpërndarës Rrapi – Shkolla e Marinës;
Rivënia në punë e depove të Vilat, Uji i Ftohtë;
Rehabilitimi i Stacioneve të pompimit 2&3;
Zëvendësimi i linjave kryesore të dërgimit.

Një tjetër projekt, **Ndërtimi i Ujësijellësit në Rrugën Transballkanike**, për këtë është shpallur procedura e tenderit të hapur më datë 25.08.2020 me një vlerë limit prej 150,000,000.00.

Ndërkohë që Bashkia e Vlorës ka shpenzuar për vitin 2019, në procedurë prokurimesh vlerën 24,781,195 Lekë, për furnizim vendosje matësish uji dhe një tjetër tender në vlerën 19,252,348 Lekë gjithashtu për për furnizim vendosje matësish uji.

Gjithsesi vlen të përmendet fakti se situata në lagje të veçanta të Vlorës për furnizimin me ujë të pijshëm vazhdon të mbetet problematike. Duke shpresuar se investimet e fundit do të adresojnë edhe nevojat e lagjeve periferike, gjatë vitit 2021, investimet do të sjellin edhe ndikim edhe në dëmtimin e rrugëve të shtruara në qytet, ndërsa një pjesë e mirë e banorëve janë ende të pa informuar për ndërhyrjet që janë buxhetuar.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 50%+ dhe është prioritet i adresuar pjesërisht (Prioritet i buxhetuar dhe prioritet i prokuruar), ndërsa projektet e planifikuara nuk mbulojnë gjithë zonat që aktualisht kanë nevojë për përmirësim të këtij shërbimi.

Novoselë. Ndërhyrje në rrjetin e amortizuar që krijon probleme me furnizimin veçanërisht gjatë verës.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:



Gender Alliance for Development
Qendra Aleanca Gjinore për Zhv.



Nisur nga komunikimi zyrtar i realizuar me 'Ujësjetës Kanalizime Vlorë sh.a' rrjeti në këtë Nj.A është tepër i amortizuar, pasi linja kryesore ka probleme të mëdha. Për këtë arsye ky prioritet ka marrë vëmendje në krijimin e një ndërhyrje më të gjerë. Është përgatitur nga Bashkia Vlorë dhe aprovuar nga Këshilli Bashkiak lista e prioritetëve për ndërhyrje në rrjetin e ujësjetësve të 15 fshatrave të zonës, në pritje për të gjetur fonde.

Aktualisht Bashkia e Vlorës, ka tenderuar projekti: - Shërbimin e Konsulencës për "Rikonstruksionin e Ujësjetës në Nj.A. Novoselë" ku përfshihen 15 fshatra, me vlerën 7716000000 lekë për përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë nga UK Sh.a. Vlorë, Gjithsesi raportohet edhe për ndërhyrje të pjesshme për të përmirësuar situatën aktuale. Në disa fshatra të Novoselës janë vendosur tuba për zëvendësimin e rrjetit të amortizuar ose riparimin e defekteve.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 20%+ dhe është prioritet i pa realizuar. Është hartuar vetëm projekti për shërbimin e konsulencës.

Orikum. Me prioritet ndërhyrjet në Dukat të Ri dhe Dukat fshat.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:

Projekti I furnizimit me ujë të pijshëm për fshatrat Dukat-Tragjas-Jonufër-Radhimë, financuar nga FSHZH dhe bashkëfinancim nga Bashkia Vlorë, për paisjen me furnizim me ujë të pijshëm 24 orë, është në fazën e finalizimit. Mendohet se brenda vitit 2020 do të përfundojë projekti i ujësjetës të ri dhe do të meret në dorëzim nga Bashkia Vlorë, duke adresuar plotësisht këtë shqetësim të banorëve.

Nisur nga komunikimi zyrtar i realizuar me 'Ujësjetës Kanalizime Vlorë sh.a' ky institucion është në fazën e zhvillimit të projekteve dhe gjetjes së financimeve për qytetin e Orikumit.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 80%+ dhe është prioritet i adresuar pjesërisht (drejt finalizimit të ujësjetës të ri).

Qendër Vlorë. Furnizim me ujë për fshatrat Bestrovë, Babicë e Vogël, Hoshtimë, Kërkovë dhe Panaja.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:

Nga ndërmarrja e UK Sh.a Vlorë raportohet se është montuar një pompë e re në Shushicë dhe është shtrirë linja e re Ø 90 në Babicë, ndërsa do të vazhdojë puna për shtrimin e një tjetër linje

Ø 90 ml- 150 ml për përmirësimin e furnizimit me ujë. Pritet që ti jepet një zgjidhje provizore me puse edhe me pompa, por ende nuk kemi të dhëna për ndryshim të situatës.

Ndërsa fshatrat Bestrovë, Hoshëtimë, Kërkovë dhe Panaja, vazhdojnë të vuajnë mungesën e ujit, ende nuk shihet ndonjë reagim nga institucionet përgjegjëse.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 10% dhe është prioritet i pa realizuar

Shushicë. Furnizim me ujë për fshatrat Llakatund, Beshisht dhe Bunavi, përmirësim i cilësisë së ujit në Drithas dhe Grabian.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:

Nga ndërmarrja e UK Sh.a Vlorë raportohet se është montuar një pompë e re dhe një pus shtesë në Shushicë, për të rritur sasinë e ujit. Gjithashtu është pastruar depoja në Grabian për furnizimin me ujë sa më cilësor. Është hartuar projekti për rindërtimin e ujësjellësit në Babicë të vogël dhe pritet financim për investim. Ndërsa për vitin 2020 është parashikuar të realizohet projektimi i "Furnizimit me ujë ujësjellësi Llakatund".

Me gjithë shpjegimet e Bashkisë dhe UK Vlorë Sh.a, situata për furnizimin me ujë mbetet ende një prioritet që duhet zgjidhur.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 20%+ dhe është prioritet i pa realizuar

PRIORITET NR. 3: KANALIZIMET

- **Përmirësim të cilësisë së kanalizimeve në secilën prej njësive vijuese:**

Rajonet e qytetit Vlorë. Kryerje e investimeve në rrjetin e kanalizimeve në zonat periferike dhe vënia në funksion e impiantit të përpunimit të ujrave të zeza në zonën e bregdetit.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:

Nisur nga komunikimi zyrtar i realizuar me UK Vlorë Sh.a, vazhdon puna për sistemimin e kanalizimeve të ujërave të zeza në Lungomare. Ndërsa raportohet se impianti i derdhjes së ujrave të zeza në det, është në punë, që në Mars 2019. Është lidhur edhe me ujërat e bardha të shiut duke evituar përmytjet nga shiu. Impianti është në funksion prej verës së 2019, ndërsa për gjithë pjesën e pa trajtuar nga projektet e mëparshme të derdhjes së ujrave të zeza në Lungomare, është hartuar projekti dhe është depozituar pranë EREU-së, ku është tenderuar përgjatë 2019. Projekti do të ridimensionojë stacionet e pompimit ekzistues, ndërkohë që edhe

vetë Bashkia e Vlorës ka buxhetuar me fondin 1.500.000 trajtimin e ujrave të ndotur përgjatë Lungomares.

Ndërsa për stacionet periferike të investimeve në rrjetin e Kanalizimeve, raportohet se ka mbaruar 90% e punës në Kuzbaba, Fabrika e Çimentos, zona e spitalit “Ali Mihali”, zona e Ujit të Ftohtë. Po vazhdon puna edhe më rehabilitimin e stacioneve të pompimit të KUZ.

Vlerësojmë maksimalisht performancën e UK Vlorë, Sh.a, për përmbushjen e këtij prioriteti, ndërsa mbetet ende shumë punë dhe projekte që duhen finalizuar dhe financuar për pjesët e tjera periferike të Vlorës.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 80%+ dhe është prioritet i realizuar.

Novoselë, Orikum, Qendër Vlorë dhe Shushicë. Ndërhyrje në sistemin e kanalizimeve, me prioritet në Njësinë Administrative Qendër dhe Shushicë dhe në zonat ku kanalizimet funksionojnë me gropa septike, si dhe specifiktë në fshatrat Mifol dhe Akërnj.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:

Nisur nga komunikimi zyrtar i realizuar me UK Vlorë Sh.a është hartuar projekti për rrjetin KUZ Fitore dhe KUB Novoselë (ujëra të zeza dhe të bardha). Në Orikum po hartohet projekti për KUZ dhe për vënien në punë të impiantit të ujërave të ndotura, financuar nga FSHZH dhe KFW. Ndërsa ata pohojnë se në Nj.A Novoselë, Qendrë, Shushicë nuk ka rrjet kanalizimesh dhe deri për periudhën e raportimit nuk ka një projekt përfundimtar për ndryshimin e situatës.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 40%+ dhe është prioritet i adresuar pjesërisht.

PRIORITET NR. 4: TRANSPORTI PUBLIK

- **Zgjidhje e problemit të transportit për fëmijët e shkollës në Dukat dhe të shkollës së Sherishtës.**

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:

Sipas specialistes për transportin në Bashkinë e Vlorës, për transportin e fëmijëve janë të licencuara dy shoqëri, njëra që bën rrugën, Vlorë-Radhimë-Tragjas-Orikum-Dukat, dhe tjera që bën këtë rrugë në kthim. Këtij problemi i është dhënë zgjidhje duke i transportuar fëmijët në statusin e pasagjerit në linjë ndërqytetëse. Pra nxënësi transportohet si pasagjer.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 100% dhe është prioritet i realizuar.

PRIORITET NR. 5: TRANSPORTI PUBLIK

- Shtim i shërbimit të transportit urban dhe në lagjet periferike të qytetit. Orare fikse, linja më të shpeshta transporti dhe rritje e orarit të shërbimit përtej orës 18.00

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:

Sipas specialistes për transportin në Bashkinë e Vlorës, situata me këtë prioritet është pak delikate duke mbajtur në konsideratë dhe situatën e pandemisë. Në Plazh të Vjetër ka transport urban. Për sa i takon Linjës nga Fabrika e Tullave, Transballkanike, nuk ofrohet si shërbim pasi nuk ka përfunduar rregullimi i një pjesë të rrugës. Sa për fushën e aviacionit linja është e miratuar me vendim të këshillit bashkiak, por ende kjo zonë është pa shërbim transporti. Gjithsesi qytetarët mendojnë se nevojë për shtim të linjave të reja të transportit. Ekziston vetëm një linjë, dhe duhet të tenderohet linja e dytë, por për shkak të pandemisë situata ka ngelur pezull.

Në lidhje me prioritetin që të ketë transport urban edhe pas orës 18.00 nuk ka asnjë progres, por situata është pozitive pasi janë raporte të hapura që Bashkia e Vlorës ka me shoqëritë e transportit, dhe ky prioritet mund të përmbushet, por theksojmë që situatat me transportin publik ka qenë dhe është disi e vështirë nga situata Covid-19.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 50% dhe është prioritet i adresuar pjesërisht.

PRIORITET NR. 6: PASTRIMI

- Të vihet në funksion impianti i venddepozitimit të mbeturinave në Sherishtë.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:

Prej janarit të 2020, në bazë të VKB nr. 36, datë 28.03.2019 është ngritur dhe ka filluar funksionimin ndërmarrja e për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane në Bashkinë e Vlorës. Kjo ndërmarrje nuk ende fonde ndërkohë që pritet të mbarojnë punimet në venddepozitim.

Ndërsa prej qershorit të 2020, ka filluar puna për ndërtimin e venddepozitimit të mbeturinave në Sherishtë, ku do të përfitojnë bashkia Vlorë dhe bashkia Selenicë, me kredi të bankës gjermane KfE. Përveç venddepozitimit që do të ketë një kapacitet prej 580 mijë m³, parashikohet të ndërhyet edhe për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura ka një kapacitet 75 m³/ditë, ndërsa impianti i riciklimit dhe paketimit 55 mijë tonë në vit. Po ashtu parashikohet ndërtimi i 50 kontejnerëve nëntokësorë në zonën turistike të Lungomares. Sipas komunikimeve projekti do të realizohet me teknologji bashkëkohore dhe standarde europiane.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 50%+ dhe është prioritet i adresuar pjesërisht.

PRIORITET NR. 7: PASTRIMI

- Përmirësim i cilësisë së pastrimit sipas nevojave të secilës njësi:

Rajonet e qytetit Vlorë. Shërbim cilësor dhe shtimi i koshave në disa zona të qytetit, sidomos gjatë sezonit turistik. Pastrim nga inertet në rrugët ku ka pasur rikonstrukcion (p.sh rruga "Shyqyri Alimerko"). Në pjesën e "Lungo Mares" i domosdoshëm shtimi i koshave sidomos në rrugët dytësore që dalin në të. Të shtohen masat e kontrollit të Bashkisë në zonat ku banorët bëjnë djegie të mbetjeve kryesisht plastikave, veçanërisht në ish-fushën e druve dhe ish-fushën e avionit.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:

Sipas specilistëve në Bashkinë Vlorë dhe nga kthimi i përgjigjes së kërkesës për informim raportohet se është bërë pastrimi i interteve në zona të caktuara ku kryhen punime, në rrugën Shyqyri Alimerko janë hequr gjithë inertet dhe është pastruar territori. Ndërsa në Lungo Mare me tenderimin e ri të firmës së pastrimit, larja e rrugës nga një herë në ditë raportohet se në kontratën e re kryhet tre herë në ditë si zonë turistike e rëndësisë së veçantë. Gjithashtu do të shtohet numri i koshave të rinj me 1064 kosha në total vetëm për qytetin e Vlorës. Këtu i referohemi kontenierëve të mëdhenj që do të vendosen nga dy ose tre në pikat ekzistuese të mbledhjes së mbeturinave në qytet, kjo me miratim të Këshillit Bashkiak.

Pastrimi i qytetit të Vlores kryhet nga firma "Duka" shpk, e cila ka fituar tenderin për 3 vjet me një fond prej 698 022 984 lekë. Ky fond sigurohet nga të ardhurat e Bashkisë.

Gjatë pandemisë nuk është ndërperë shërbimi i pastrimit, ndërsa gjatë periudhës së izolimit është shtuar kujdesi për larjen e rrugëve me detergjent dhe disinfektimin e kontenierëve.

Në bashkëpunim me banken gjermane KFW po negociohet për zëvendësimin e kontenierëve, ndërtimin e bazamenteve dhe implementimin e kontenierëve të nendheshëm në një zonë pilot.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 70%+ dhe është prioritet i realizuar.

Novoselë. Vendosja e koshave për mbledhjen e mbeturinave në çdo fshat. Nevojitet të shtohen 140 kosha të tjerë.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:

Në Nj.A Novoselë pritet që kompania e kontraktuar të sjellë shërbime me cilësore, ndërkohë që parashikon edhe vendosje të koshave të rinj. Me vendim të KB është miratuar edhe

shpërndarja e koshave në të gjithë njësitë administrative që mbulohen nga shërbimi që do të ofrojë firma e kontraktuar nga Bashkia.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 0 dhe është prioritet i pa realizuar.

***Orikum.** Vendosje e koshave në lagjet brenda fshatrave dhe dezinfektimi i koshave ekzistues. Eliminimi i plotë i djegies së plehrave.*

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:

Sipas specialistit përkatës në Bashkinë Vlorë, djegia e mbeturinave vazhdon të jetë problem, edhe pse policia bashikake e ka vënë disi nën kontroll situatën. Për këtë qytetarët duhet të jenë më të përgjegjshëm, gjithsesi pastrimi i Njesise Administrative Orikum realizohet nga firma në sipërmarrje “Baitel” sh.p.k. që ka fituar tenderin 3 – vjeçar me një fond prej 78 941 978 lekë. Ndërsa në fshatra vazhdon të jetë e njëjta situatë dhe nuk ka investime për shtimin e koshave të rinj. **Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 10% dhe është prioritet i pa realizuar.**

***Qendër Vlorë.** Bashkia të kontraktojë firmë pastrimi ose nëpërmjet Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike të vendosë kosha për mbledhjen e mbeturinave në të gjitha fshatrat. Mbledhja sistematike e mbeturinave nga makinat e pastrimit në të gjitha fshatrat e kësaj njësie.*

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:

Në muajin gusht ka filluar punën firma fituese e tenderit për pastrimin e Nj.A Qendër dhe Shushicë, pas zgjidhjes së problemit në Gjykatë. Ndërsa vetë bashkia përmes Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike ka ofruar këtë shërbim përgjatë vitit 2020, në fshatrat Nartë, Bestrovë, Panaja, Babicë, Xhyherinë, Sherishtë duke pastruar mbetjet urbane rreth 800m³.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 10% dhe është prioritet i pa realizuar.

***Shushicë.** Urgjente shtimin e koshave të mbetjeve në të gjithë njësinë. Prioritet pastrimi në fshatrat Risili, Çeprat, Mekat, Bunavi, Beshisht dhe Drithas.*

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:

Sipas specialistit përkatës në Bashkinë Vlorë na bëri me dije se për të dyja njësitë administrative është në veprim e njëjta kompani. Dhe situata paraqitet me përmirësime modeste.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 10% dhe është prioritet i pa realizuar.

PRIORITET NR. 8: ZHVILLIM EKONOMIK

- Zhvillim i programeve për mbështetjen e fermerëve, si dhe përfundim i procesit të menaxhimit të tokave.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:

Ndërsa territori i Bashkisë Vlorë është zgjeruar, fermerët ende nuk kanë mundësi të përfitojnë shërbime konkrete. Gjatë muajve të verës kryetari i Bashkisë ka ndërmarrë një tur takimesh pranë fermerëve në Nj.A të ndryshme, duke u njohur nga afër me nevojat e tyre. Mbetet prioritet që të zgjerohen shërbimet e Bashkisë për këtë kategori ndërsa AZHBR-ja, përmes Agropikës ka ofruar informacione mbi aplikimet për mbështetjen e sektorit bujqësor. Nga komunikimet me aplikuesit vazhdon të parpaqiten vështirësi për të përfituar në këto fonde.

Ndërsa në lidhje me përfundimin e procesit të menaxhimit të tokave, vazhdohet te ecet me ritme të ulta, edhe pse nevojat vazhdojnë të jenë të larta nga qytetarët. Pasi përgatitet dokumentacioni ligjor nga ana e stafit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak zakonisht miraton cdo kërkesë për njohjen e pronave të tokave bujqësore. Përsheptimi i këtij procesi ndikon edhe në programin e mbështetjes së fermerëve, të cilët mund të aplikojnë për mbështetje nga fondet e AZHBR-së për mbështetje financiare.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 50%+ dhe është prioritet i adresuar

PRIORITET NR. 9: Zhvillimi i një mekanizmi efektiv nga Bashkia për mbledhjen e taksave ku të përfshihen edhe fushata informimi e komunikimi me komunitetin mbi mbledhjen dhe rishpërndarjen e tyre.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:

Nga ana e Bashkisë nuk ka patur një fushatë të mirëfilltë sensibilizimi për mbledhjen e taksave, kjo lidhur edhe me periudhën e konstituimit, në muajin gusht 2019 dhe nw vazhdim. Gjithsesi nga ana e bashkisë janë informuar derë me derë subjektet ekonomike, ndërsa për qytetarët nuk janë shpërndarë njoftime. Përsa i përket Nj.A, nuk është realizuar asnjë fushatë informimi me komunitetin. Gjithsesi Bashkia Vlorë konfirmon për nivele të ulta të mbledhjes së taksave kryesisht në disa Nj.A ndërsa në qytet ka dallime edhe nga rajoni në rajon. Krahasuar me gushtin e 2019, me të njëjtën periudhë të 2020 është realizuar 91% e planit, ndërsa vjelja e taksave dhe tarifave krahasuar me vitin 2019 është 36%.

Gjatë monitorimit të takimeve të Buxhetimit me Pjesëmarrje, gjatë muajit nëntor – dhjetor 2019, në zonat urbane dhe rurale janë dhënë informacione rreth taksave dhe tarifave dhe mbledhjes së tyre në cdo zonë.

Gjithsesi në faqen e internetit të Bashkisë Vlorë <http://vlora.gov.al/paketa-fiskale/>, ekziston një informacion i rifreskuar për vitin 2020, mbi detyrimet dhe llojet e taksave dhe tarifave që duhet të paguajnë qytetarët. <http://vlora.gov.al/transparenca/taksa-dhe-tarifa-vendore/>

Rekomandohet që Bashkia Vlorë, të mos limitohet vetëm në takimet e Buxhetimit me Pjesëmarrje dhe publikimit në internet, por të njoftojë rregullisht qytetarët mbi taksat dhe tarifatat që duhet të paguajnë, në kohë duke përdorur njoftimet alternative kryesisht ato online apo komunikimet në mediat sociale dhe lokale për çdo detyrim fiskal.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 10%+ dhe është prioritet i pa realizuar

PRIORITET 10: Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës për të rinjtë dhe gratë.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:

Nga Bashkia e Vlorës nuk ka asnjë përgjigje për këtë prioritet. Nga monitorimi i realizuar nuk ka një zyrë, ose person përgjegjës që mbulon këto shërbime. Gjithsesi Bashkia e Vlorës ka nisur një bashkëpunim me një organizatë prej 2017, ku është miratuar VKB nr.87, për ndjekjen e procedurave të kontratës së financimit dhe zbatimit të projektit “Set Tour Lab- Stimulimi i punësimit nëpërmjet inkubatorit inovativ të turizmit në Vlorë”. Nëpërmjet këtij vendimi është mundësuar përthithja e fondeve nga donatorë të huaj të cilët mundësuan rikonstruksionin e ambienteve të zyrave të ish Ndërmarrjes së Rrugëve Rurale Vlorë, duke e kthyer në ambiente të përshtatshme në formën e laboratorit turizmi. Synimi i përshtatjes dhe rehabilitimit të këtyre ambienteve ka qenë që Set Tour Lab ose i quajtur ndryshe Laboratori i Turizmit të kthehet në një inkubator rajonal të bizneseve turistike, duke përmirësuar situatën e punësimit të të rinjve dhe të papunëve në qytetin e Vlorës dhe më gjerë në gjithë rajonin e jugut të Shqipërisë. Me VKB nr.110 datë 27.11.2019 “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit “Mbi realizimin e Aktiviteteve Kulturore” ndërmjet Bashkisë Vlorë, AICS Tirana, dhe BIZNES ALBANIA”, është miratuar një tjetër bashkëpunim. Priten në vijim, veprime konkrete për vënien në funksion të laboratorit të turizmit për të rritur aksesin e të rinjve në tregun e punës përmes formimit profesional. Ndërsa stafi i bashkisë, kryesisht sektori i turizmit ka promovuar punësimin e të rinjve ose grave, përmes realizimit të panairove dhe aksesin në informacion për mundësitë e punësimit gjatë sezonit turistik.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 10%+ dhe është prioritet i pa realizuar

PRIORITET NR. 11: DEMOKRACIA VENDORE

Bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektiv (Buxhetimi me Pjesëmarrje) për të marrë këndvështrimin e komunitetit mbi vendimarrjet më të rëndësishme, duke:

- mos u limituar vetëm tek konsultimi i buxhetit por dhe mbledhje të nevojave të qytetarëve;
- përdorur edhe forma të tjera konsultimi përveç takimeve me komunitetin, si dhe duke rritur numrin e takimeve konsultuese;
- mundësuar përfshirjen e gjerë të komunitetit në këto procese;
- raportuar sistematikisht në komunitetet se sa prej mendimeve të komunitetit janë reflektuar në vendimarrjet e saj.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:

Bashkia Vlorë vlerësohet pozitivisht për realizimin e procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje. Ajo ka përmirësuar implementimin e procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje, ka zhvilluar dëgjesa të hapura të cilat janë dokumentuar me rregjistime dhe publikime në mediat sociale dhe lokale, ndërsa vazhdon të konsolidojë efektivitetin e këtij mekanizmi. Gjithsesi vlen të përmendet fakti që ka përfshirje dhe reagim qytetar gjatë dëgjesave të realizuara përgjatë periudhës tetor-dhjetor 2020, ndërsa buxheti afatmesëm nuk u konsultua, edhe për faktin se ishte periudhë pandemie. Vlerësojmë faktin se në faqen e internetit janë të zbardhura gjithë takimet e realizuara për Buxhetimin me Pjesëmarrje <http://vlora.gov.al/degjesat-publike/> Bashkia e asistuar edhe nga organizata lokale, përdor edhe metoda të mbledhjes së perceptimeve dhe prioriteteve online, përmes anketimit të qytetarëve.

Mbetet ende për të bërë, lidhur me detyrimet ligjore për zbatimin e ligjit të njoftimit dhe konsultimit publik, gjithsesi vlerësohet si progres pozitiv realizimi i këtij prioriteti.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 80%+ dhe është prioritet i realizuar

PRIORITET NR.12: DEMOKRACIA VENDORE

- **Të krijohet Këshilli Rinor Vendor për të rritur pjesëmarrjen e të rinjve në vendimarrjen lokale.**

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi deri në gusht 2020:

Çdo bashki ka për detyrë të përgatisë politikat dhe planet për rininë si dhe të raportojë për zbatimin e tyre. Sipas Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015-2020, çdo NJQV duhet të ketë një departament për të rinjtë ose staf të dedikuar për këtë gjë. Këshillat bashkiakë duhet të planifikojnë një buxhet specifik për financimin e programeve dhe iniciativave rinore. Gjithashtu, bashkitë duhet të hartojnë plane veprimi për të rinjtë që do të drejtojnë zhvillimin



Gender Alliance for Development
Qendra Aleanca Gjinore për Zhv.



dhe aktivitetet rinore në nivel lokal. Kjo politikë në nivel lokal do t'u mundësojë aktorëve vendorë të identifikojnë dhe adresojnë çështjet dhe sfidat që lidhen me të rinjtë në fushën e ofrimit të shërbimeve, të arsimit (formal dhe jo formal), të punësimit, të sigurisë, të kohës së lirë etj.

Në mbështetje dhe zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, Neni 9 “Të drejtat e njësive të qeverisjes vendore”, pika d) Krijojnë komitete, borde ose komisione për kryerjen e funksioneve të veçanta sa herë që paraqitet nevoja, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore dhe Neni 16 “Konsultimi publik në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, pika 1) Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes, në vullnetin e tyre të plotë dhe respekt ndaj qytetarëve dhe bazuar mbi Ligjin për Rininë, neni 10, Bashkia e Vlorës ofron disa shërbime në territorin e saj për të rinjtë që janë si më poshtë:

Ka ngritur Këshillin Vendor të Rinisë, më datë 15 janar 2020, me numër 590, datë 20.01.2020. Kjo strukturë është formalizuar përmes një marrëveshje bashkepunimi me Kryetarin e Bashkisë dhe kryetaren e Këshillit Bashkiak dhe përfaqësuesve të Këshillit Vendor të Rinisë.

Një zë i veçantë për realizimin e Planit Lokal dhe iniciativave rinore është vendosur në Buxhetin e Bashkisë Vlorë në total prej 500.000 lekë, prej vitit 2014 deri në 2019. Në planifikimet buxhetore të rinjtë janë përfshirë së bashku me shërbimet që ofrohen për sportin.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 50%+ dhe është prioritet në progres.

Përfundime dhe Rekomandime

Prioritetet e Kontratës Sociale për Vlorën të propozuara nga komuniteti bazuar mbi nevojat e tij. Gjatë këtij monitorimi në periudhën gusht 2019 – gusht 2020 u vu re një lëvizje pozitive nga ana e bashkisë për të përmbushur disa prej prioriteteve të dala nga qytetarët e Vlorës. Por, megjithatë, gjatë këtij monitorimi doli në pah që situata pandemike e cila është aktuale që prej muajit mars 2020, ktheu vëmëndjen e bashkisë drejt prioriteteve më emergjente sa i përket menaxhimit të situatës pandemike COVID-19 dhe pasojave të saj.

Qendra Rinore e Vlorës do të vijojë monitorimin e punës së bashkisë, drejtorive përkatëse si edhe vendimeve të Këshillit Bashkiak pranë kësaj bashkie, dhe bazuar në Kontratën Sociale listojmë disa rekomandime:

Infrastruktura:



Gender Alliance for Development
Qendra Aleanca Gjinore për Zhv.



Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile
Civil Society Development Center



Association for Integration of Social Minorities



"Young Intellectuals, Hope"
"Intelektualët e rinj, Shpresa"



- Rekomandohet të vazhdojë puna në drejtim të rikonstruksionit të blloqeve të brendshme të banimit dhe rrugëve dytësore në qytet, si edhe në rrugët të cilat shihen si prioritare nga komuniteti në fshatra.

Furnizimi me ujë të pijshëm:

- Rekomandohet të punohet për përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm dhe furnizimin me ujë 24 orë në qytet;
- Rekomandohet ndërhyrje në rrjetet e amortizuara në njësitë administrative.

Kanalizimet:

- Rekomandohet investim për rrjetin e kanalizimeve në zonat periferike dhe fshatra, si dhe vënia në funksion e impiantit të përpunimit të ujërave të zeza në zonën e bregdetit.

Transporti:

- Të përmirësohet shërbimi i transportit publik nga qendra drejt zonave periferike dhe në linjat që mbulojnë Nj. A.

Shërbimi i pastrimit:

- Rekomandohet përmirësimi i shërbimit në Nj. A dhe shtimi i koshave në rrugët kryesore.

Zhvillimi ekonomik vendor:

- Rekomandohet që bashkia të hyjë në bisedime dhe të bëjë marrëveshje me bizneset lokale kryesisht në sektorin e turizmit, për punësimin e grave dhe të rinjve;
- Rekomandohet që bashkia të iniciojë programe për arsimin profesional dhe rritjen e kualifikimit të personave që janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike, të rinjtë dhe grate, me qëllim punësimin e shpejtë të tyre.
- Bashkia duhet të bëhet më efikase për të shpejtuar zhvillimin ekonomik në zonat e zhvilluara bujqësore përmes investimit në rrugët lidhëse me qytetin dhe furnizimin me ujë duke sjellë zhvillim të ekonomive familjare.

Demokracia Vendore:

- Rekomandohet që Bashkia Vlorë, të ndërveprojë seriozisht me të rinjtë në territorin e saj. Këshilli Vendor i Rinise duhet të marrë pjesë dhe të bashkëpunojë me Bashkinë Vlorë dhe Këshillin Bashkiak për të orientuar shërbime dhe programe sa më cilësore për të rinjtë.

Taksat dhe Tarifat:

- Rekomandohet që qytetarët të informohen në kohë mbi detyrimin e tarifave dhe taksave vendore duke u bërë pjesë e procesit të planifikimit të buxhetit.
- Rekomandohet që qytetarët të informohen më konkretisht ku shkojnë taksat e tyre.
- Rekomandohet që bashkia të rrisë transparencën lidhur me të ardhurat e mbledhura dhe menaxhimin e tyre

Buxhetimi me Pjesëmarrje:

- Sugjerohet zbatimi i Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

- Bashkia të shkojë me shpesh në njësitë administrative rurale për takime publike me grupe interesi kur hartohen projekt buxheti ose konsultime për studime e projekte të ndryshme.

Referenca

Faqja zyrtare e bashkisë Vlorë <http://vlora.gov.al/>

Faqja zyrtare e Këshillit të Bashkisë <http://vlora.gov.al/category/degjesat-publike/>

Dëgjesat publike për Buxhetimin me Pjesëmarrje <http://vlora.gov.al/pjesemarrja-qytetare-ne-vendimmarrie/>

Kontrata Sociale Vlorë <https://popnetwork.al/kontrata-sociale-me-prioritetet-kryesore-vlore/>

Takim me nën kryetarin e Bashkisë <https://popnetwork.al/takime-me-komunitetin-e-bashkise-vlore/>

Raporti mbi monitorimin e periudhës së pandemisë Covid-19, Bashkia Vlorë <https://popnetwork.al/raporti-i-monitorimit-bashkia-vlore/>



Gender Alliance for Development
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim





Suedi
Sverige



Gender Alliance for Development
Qendra Aleanca Gjinore për Zhv



Aneks

Aneks 1. Legjenda e adresimit të prioriteteve

PRIORITET 1: Investime që përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore dhe blloqet e brendshme të banimit..	50%	Progres i adresuar pjesërisht
Për rajonet e qytetit Vlorë. I nevojshëm rikonstruksioni i rrugëve ose i blloqeve të brendshme të banimit: Zona tek Fusha e Drurit, rruga tek Tregu i Madh, rruga pas KSHA-së, lagjia pas kopshtit Nr 10, rruga nga fabrika e tullave, rruga nga Porti drejt plazhit të vjetër, rruga "Jani Kosta", rruga dhe e gjithë lagjia pas Stadiumit, rruga tek fusha e aviacionit. Vendosi e sinjalistikës horizontale dhe/ose vertikale në zonat ku aktualisht mungon.	50%	Prioritet i adresuar pjesërisht
Novoselë. Ka nevojë për ndërhyrje urgjente në rrugët kryesore në fshatrat: Trevllazër, Cerkovinë, Skrofotinë, si dhe rruga e varrezave Cerkovinë	100%	Prioritet i realizuar plotësisht
Orikum. I nevojshëm rikonstruksioni i rrugës tek Kisha e Marmiroit, rrugës buzë detit, rrëza e kanalit Dukat, rrugët e brendshme në Tragjas. Zgjerim i rrugëve të Rradhimës dhe të Thilpetit.	10%	Prioritet i pa realizuar
Qendër Vlorë. Kërkohet ndërhyrje urgjente në rrugët lidhëse të Bestrovës, Kërkovës, Hoshtimës, Sherishtës, Babicë e Vogël dhe Xhyherinës.	40%	Prioritet i adresuar pjesërisht
Shushicë. Kërkohet rikonstruksion i rrugës Shushicë-Beshisht, rrugës së varrezave në fshatin Drithas dhe rrugës kryesore në Shushicë.	50%	Prioritet i adresuar pjesërisht
PRIORITET 2: Adresimi me prioritet i furnizimit me ujë për	36%	Prioritet i adresuar pjesërisht
Rajonet e qytetit të Vlorës. Furnizimi me ujë në zonat ku aktualisht ka ujë vetëm një herë në 24 orë. Përmirësim i cilësisë së ujit të pijshëm	50%	Prioritet i adresuar pjesërisht
Novoselë. Ndërhyrje në rrjetin e amortizuar që krijon probleme me furnizimin vecanërisht gjatë verës.	20%	Prioritet i pa realizuar
Orikum. Me prioritet ndërhyrjet në Dukat të Ri dhe Dukat fshat.	80%	Prioritet i realizuar
Qendër. Furnizim me ujë për fshatrat Bestrovë, Babicë e Vogël,	10%	Prioritet i pa realizuar

Hoshtimë, Kërkovë dhe Panaja.		
Shushicë. Furnizim me ujë për fshatrat Llakatund, Beshisht dhe Bunavi, përmirësim i cilësisë së ujit në Drithas dhe Grabian.	20%	Prioritet i pa realizuar
PRIORITET 3: Përmirësim të cilësisë së kanalizimeve në secilën prej njëjësive vijuese:	60%	Prioritet i adresuar pjesërisht
Rajonet e qytetit Vlorë. Kryerje e investimeve në rrjetin e kanalizimeve në zonat periferike dhe vënia në funksion e impiantit të përpunimit të ujrave të zeza në zonën e bregdetit.	80%	Prioritet i realizuar
Novoselë, Orikum, Qendër Vlorë dhe Shushicë. Ndërhyrje në sistemin e kanalizimeve, me prioritet në Njësinë Administrative Qendër dhe Shushicë dhe në zonat ku kanalizimet funksionojnë me gropa septike, si dhe specifikisht në fshatrat Mifol dhe Akërnj.	40%	Prioritet i adresuar pjesërisht
PRIORITET 4: Zgjidhje e problemit të transportit për fëmijët e shkollës në Dukat dhe të shkollës së Sherishtës.	100%	Prioritet i realizuar
PRIORITET 5: Shtim i shërbimit të transportit urban dhe në lagjet periferike të qytetit. Orare fikse, linja më të shpeshta transporti dhe rritje e orarit të shërbimit përtej orës 18.00	50%	Prioritet i adresuar pjesërisht
PRIORITET 6: Të vihet në funksion impianti i venddepozitimit të mbeturinave në Sherishtë	50%	Prioritet i adresuar pjesërisht
PRIORITET 7: Përmirësim i cilësisë së pastrimit sipas nevojave të secilës njësi:	20%	Prioritet i pa realizuar
Rajonet e qytetit Vlorë. Shërbim cilësor dhe shtimi i koshave në disa zona të qytetit, sidomos gjatë sezonit turistik. Pastrim nga inertet në rrugët ku ka pasur rikonstrukcion (p.sh rruga "Shyqyri Alimerko"). Në pjesën e "Lungo Mares" i domosdoshëm shtimi i koshave sidomos në rrugët dytësore që dalin në të. Të shtohen masat e kontrollit të Bashkisë në zonat ku banorët bëjnë djegie të mbetjeve kryesisht plastikave, veçanërisht në ish-fushën e druve dhe ish-fushën e aviacionit.	70%	Prioritet i adresuar pjesërisht
Novoselë. Vendosja e koshave për mbledhjen e mbeturinave në çdo fshat. Nevojitet të shtohen 140 kosha të tjerë.	0%	Prioritet i pa realizuar
Orikum. Vendosje e koshave në lagjet brenda fshatrave dhe dizinfektimi i koshave egzistues. Eliminimi i plotë i diegies së plehrave	10%	Prioritet i pa realizuar
Qendër Vlorë. Bashkia të kontraktojë firmë pastrimi ose nëpërmjet Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike të vendosë kosha për mbledhjen e mbeturinave në të gjitha fshatrat. Mbledhja sistematike e mbeturinave nga makinat e pastrimit në të gjitha fshatrat e kësaj njësie.	10%	Prioritet i pa realizuar
Shushicë. Urgjente shtimin i koshave të mbetjeve në të gjithë	10%	Prioritet i pa realizuar

njësinë. Prioritet pastrimi në fshatrat Risili, Çeprat, Mekat, Bunavi, Beshisht dhe Drithas.

PRIORITET 8: Zhvillim i programeve për mbështetjen e fermerëve, si dhe përfundim i procesit të menaxhimit të tokave.

PRIORITET 9: Zhvillimi i një mekanizmi efektiv nga Bashkia për mbledhjen e taksave ku të përfshihen edhe fushata informimi e komunikimi me komunitetin mbi mbledhjen dhe rishpërndarjen e tyre.

PRIORITET 10: Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës për të rinjtë dhe gratë.

PRIORITET 11: Bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektiv (Buxhetimi me Pjesmarrje) për të marrë këndvështrimin e komunitetit mbi vendimarrjet më të rëndësishme, duke:

- *mos u limituar vetëm tek konsultimi i buxhetit por dhe mbledhje të nevojave të qytetarëve;*
- *përdorur edhe forma të tjera konsultimi përveç takimeve me komunitetin, si dhe duke rritur numrin e takimeve konsultuese;*
- *mundësuar përfshirjen e gjerë të komunitetit në këto procese;*
- *raportuar sistematikisht në komunitetet se sa prej mendimeve të komunitetit janë reflektuar në vendimarrjet e saj.*

PRIORITET NR.12: Të krijohet Këshilli Rinor Vendor për të rritur pjesmarrjen e të rinjve në vendimarrjen lokale.

TOTALI

50%

Prioritet i adresuar pjesërisht

10%

Prioritet i pa realizuar

10%

Prioritet i pa realizuar

Prioritet i realizuar

80%

50%

Prioritet i adresuar pjesërisht

46,91%

Prioritete te adresuara pjesërisht

Aneks 2

Nr. 5/2 Prot

Vlorë, 20.7.2020



Gender Alliance for Development
Qendra Aleanca Gjinore për Zhv.



KËRKESË PËR INFORMACION
Bazuar në Ligjin Nr.119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”

Drejtuar: Z. Dritan Leli, Kryetar i Bashkisë Vlorë

Lënda: Kërkesë për Informacion në lidhje me progresin e Bashkisë Vlorë në përmbushjen e prioriteteve të Kontratës Sociale të firmosur në datë 13.10.2019

I nderuar Z. Leli

Uroj të jeni mirë me shëndet e punë.

Siç jeni në dijeni, Qendra Rinore Vlorë pjesë e Rrjetit POP1 ka nënshkruar me institucionin tuaj në datë 13.10.2019 “Kontratën Sociale” me prioritetet e dala nga komuniteti i Vlorës në lidhje me nevojat dhe përparësitë e tyre kundrejt pushtetit vendor. Qendra Rinore e Vlorës që prej fillimit të ushtrimit të detyrës suaj është duke monitoruar progresin e realizimit të prioriteteve të identifikuara nga qytetarët gjatë periudhës parazgjedhore.

Në këtë kuadër, ne do të hartojmë në fillim të muajit shtator 2020 një raport i cili do të përfshijë hapat e ndërmarra nga bashkia për plotësimin e prioriteteve të Kontratës Sociale për periudhën gusht 2019 – gusht 2020.

Bazuar në prioritetet e nxjerra nga komuniteti do ju luteshim të na informoni në lidhje me progresin e bërë nga Bashkia Vlorë.

¹ Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin të qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Ky rrjet operon në Tiranë, Durrës, Fier, Shkodër, Kukës, Pukë, Kamëz, Vlorë, Pogradec

Investime që përmirësojnë infrastrukturën: Investime në rrugët dytësore dhe blloqet e brendshme të banimit.

Si ka ecur rikonstruksioni i rrugëve dhe blloqeve të brendshme të banimit në qytetin e Vlorës në lagjen pas kopshtit nr. 10, rrugën nga fabrika e tullave, rrugën nga porti drejt plazhit të vjetër, rrugën 'Jani Kosta', rrugën dhe gjithë lagjen pas stadiumit (rruga e zjarrfikses), rrugën tek fusha e aviacionit?

A ka në qytetin e Vlorës përmirësime të mëtejshme në lidhje me sinjalistikën horizontale?

Si po ecën rehabilitimi dhe riasfaltimi i aksit Cerkovine – Skrofotine – Trevllazer?

Në çfarë faze është rehabilitimi dhe riasfaltimi i aksit Orikum – Kisha e Marmiroit? A është prokuruar ky investim? Kur është periudha kur ka ndodhur?

A ka filluar puna dhe a janë prokuruar fondet për rikonstruksionin e rrugës Oshtim?

A ka filluar puna dhe a janë prokuruar fondet për rehabilitimi dhe riasfaltimin e rrugës së Xhyherines?

Furnizimi me ujë të pijshëm:

Në sa prej zonave të qytetit të Vlorës ka furnizim me ujë të pijshëm 24 orë pa ndërprerje?

A është ky ujë i pijshëm dhe i sigurt?

Sa dhe cilat janë lagjet më problematike në qytetin e Vlorës? Çfarë parashikohet për zgjidhjen e çështjes për furnizimin me ujë të pijshëm të gjithë qytetit?

Çfarë masash janë marrë për rrjetin e amortizuar të Novoselës?

Në çfarë fazë është projekti i ujësjellësit të ri në Orikum?

Çfarë masash janë marrë për njësinë administrative të Shushicës dhe Qendër-s për furnizimin me ujë të fshatrave të tyre?

Përmirësimi i cilësisë së kanalizimeve:

Në cilën pikë është investimi i buxhetuar për 2020 për trajtimin e ujërave të ndotura përgjatë Lungomare-s?

Çfarë masash janë marrë nga Bashkia Vlorë për kryerjen e investimeve në rrjetin e kanalizimeve në zonat periferike të qytetit të Vlorës?

Çfarë masash janë marrë për sistemin e kanalizimeve në Njësitë Administrative Qendër, Orikum, Novoselë dhe Shushicë?

Transporti publik: Çfarë mase është marrë për zgjidhjen e problemit të transportit për fëmijët e shkollës në Dukat dhe Sherishtë? Kjo pyetje vlen për afatin kohor deri para shpalljes së pandemisë.

A ka ndonjë plan masash apo projekt për shtimin e shërbimit të transportit urban dhe në lagjet periferike të qytetit, që parashikojnë orare fikse, linja më të shpeshta transporti dhe rritje të orarit të shërbimit përtej orës 18.00.

Pastrimi:

A është ndërtuar vend depozitimi i mbeturinave në Sherisht? Në cilën fazë të funksionimit të saj është ndërmarrja për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane në Bashkinë e Vlorës?

Çfarë hapash janë ndërmarrë deri më tani për përmirësimin e cilësisë së pastrimit sipas nevojave të secilës njësi?

Zhvillimi ekonomik:

A ka ndonjë program ekonomik që mbështet fermerët në Bashkinë Vlorë? Cilat janë këto programe dhe sa është numri i përfituesve?

Si është progresi i procesit të menaxhimit të tokës bujqësore në Bashkinë Vlorë?

A ka gjeneruar Bashkia një mekanizëm për mbledhjen e taksave?

A ka zhvilluar Bashkia Vlorë ndonjë lehtësim për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës për gratë dhe të rinjtë?

Demokracia vendore:

Në çfarë faze është Buxhetimi me Pjesëmarrje? A ka krijuar Bashkia mekanizma të unifikuar dhe efektivë për të rritur pjesëmarrjen e komunitetit në vendimmarrje? Sfidat që ka hasur Bashkia Vlorë në implementimin e buxhetimit me pjesëmarrje?

Siç e dini pranë Bashkisë Vlorë është ngritur Këshilli Rinor Vendor, sa operativ është ky këshill në këtë moment? Si e shikoni mundësinë e bashkëpunimit me të?

Për sa më sipër, sipas prioriteteve do ju luteshim të na siguronit një takim nga afër ose të na kthenit një përgjigje zyrtare për pyetjet e mësipërme.